



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2020:050746  
Datë: 17.12.2020  
Numri i dokumentit: 01351383

A.nr.1028/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin, Hajriz Hoti, e zyrtarin Ligjor, Fatlum Gashi, në konfliktin administrativ të paditësve, V. O., Xh. Sh., Sh. M., H. B.-R. dhe P. H. të gjithë nga P., të cilët me autorizim i përfaqëson, N.P. avokat nga P., kundër të paditurës, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit në Prishtinë, për shkak të heshtjes së organit të paditur, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të autorizuarve të paditësit, e në mungesë të palës së paditur të thirrur në mënyrë të rregullt më dt.17.12.2020, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësve, V. O., Xh. Sh., Sh. M., H. B.-R. dhe P. H. të gjithë nga P., dhe detyrohet e paditura, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit në Prishtinë, që në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, të merr aktvendim sipas ankesës së paditësve të dorëzuar te e paditura me dt.18.04.2017, dhe të njëjtin t'ia dorëzoj paditësve sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në prezencë të autorizuarit të paditësve, e në mungesë të paditurës të thirrur në mënyrë të rregullt.

I autorizuari i paditësve av.N.P. në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se fillimisht bënë rregullimin e padisë në kuptimin subjektiv dhe objektiv ashtu që tani e tutje në cilësinë e paditësit përveç, V.O. janë edhe Xh. Sh., Sh.M., H. B.-R. dhe P. H. të gjithë nga P.. Ndërsa për shkak të ndryshimeve strukturore tani e tutje, tani palë e paditur është Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit. Ka theksuar se duke marrë për bazë aktvendimin e Gjykatës së shkallës së dytë dhe faktet e çështjes pasi që kemi të bëjmë me padi për konflikt administrativ për shkak të heshtjes së administratës, kërkesa e paditësve është që të aprovohet padia-kërkesëpadia dhe në kuptim të nenit 46 par 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe të urdhërohet e paditura që të nxjerr vendimin sipas ankesës së paditësve në afat prej 30 ditësh.

E paditura, përmespërgjigjes në paditë datës;19.04.2019, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit pa bazuar, dhe i ka propozuar Gjykatës që pas

administrimittëprovaveqëgjenden në shkresat e lëndës, padiadhekërkesëpapia e paditësit, tërefuzohet në tërësisë e pa bazuar.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.17.12.2020, ka bërë administrimin e provave dhe atë;referenca e lëshuarngaKomuna e Prishtinës e dt.24.04.2017, ankesa e paditësitdrejtuartëpaditurës e dt.18.04.2017, referenca e lëshuarnga e paditura me dt.27.03.2017 sëbashku me përgjigjen ne kërkesë e tënjëjtësdatë, vendimiiKomunës se Prishtinësi dt.02.02.2017, kërkesa e paditësitdrejtuartëpaditurës përnxjerrjen e aktit e dt.01.06.2017, procesverbaliilëshuarnga e paditura me dt.20.03.2017, dhe dt.21.01.2013, vendimii tëpaditurësi dt.21.01.2013, aktvendimikësajGjykatei dt.29.11.2019, sidheaktvendimet e Gjykatës se Apelit tëKosovëstë dt.26.02.2020, dhetë dt.11.03.2020

Nga shkresat e lëndës, gjykata vëren se paditësi, V. O. më dt.18.04.2017, i është drejtuar, ish të paditurës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë me ankesë, duke i kundërshtuar vendimet e Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës të dt.02.02.2017, mirëpo e paditura nuk ka vepruar në afatin e caktuar ligjor e as më pas. Po ashtu, më dt.01.06.2017, paditësi ka parashtruar kërkesë për të vendosur lidhur me kërkesën e dt.18.04.2017, por e paditura nuk ka marrë asnjë vendim edhe pas kërkesës së paditësit, të dt.01.06.2017, e as që e ka njoftuar të njëjtin lidhur me çështjen në procedurë.

Me nenin 136 të Ligjit për Procedurën Administrative nr. 02/L-28 është përcaktuar se “Organi administrativ që shqyrton ankimin vendos: a) lënien në fuqi të aktit dhe rrëzimin e ankimit; b)shfuqizimin/revokimin e aktit dhe pranimin e ankimit; c) ndryshimin e aktit administrativ duke pranuar pjesërisht ankimin; d) detyrimin e organit administrativ kompetent për të nxjerrë aktin administrativ kur është refuzuar pa të drejtë nxjerrja e tij”. Në këtë rast e paditura, ka pasur obligim që të marrë vendim lidhur me ankesën e paditësit, ndërsa e paditura në kundërshtim me ligjin, ka heshtur dhe nuk ka marrë vendim, e as nuk i është përgjigjur në asnjë formë paditësit. Ndërsa me nenin 131.2 të te njëjtit ligj, është përcaktuar se “Organi administrativ kompetent shqyrton ankimin administrativ dhe nxjerr vendim brenda 30 ditësh nga data e dorëzimit të ankimit. 131.2. Në qoftë se me kalimin e afatit të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni nuk është nxjerrë asnjë vendim mbi ankimin nga organi administrativ kompetent, palëve të interesuara iu lind e drejta për t’iu drejtuar gjykatës në përputhje me ligjin mbi procedurën civile në fuqi”.

Kurse me nenin 29 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative nr.03/L-202, është përcaktuar se “1. Nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e nxjerr as në afatin e mëtejme prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t’i është refuzuar ankesa. 2. Në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1. të këtij neni mund të veprojë pala edhe kur sipas kërkesës së saj nuk është nxjerrë vendimi nga organi i shkallës së parë, kundër aktit të të cilit nuk mund të bëhet ankesa. 3. Nëse organi i shkallës së parë, kundër aktit të të cilit mund të bëhet ankesa, nuk ka nxjerrë asnjë vendim në bazë të kërkesës brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh ose në një afat më të shkurtër të paraparë me dispozita të veçanta, pala ka të drejtë t’i drejtohet me kërkesë organit të shkallës së dytë. Kundër vendimit të organit të shkallës së dytë, pala mund të fillojë konfliktin administrativ, por mundet, nën kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni, ta fillojë edhe nëse ky organ nuk ka nxjerrë vendim. Nëse organi i shkallës së dytë, në afatin prej 30 ditësh, nuk merr aktvendim sipas ankesës-kërkesës, e këtë nuk e bënë as në afatin tjetër prej 7

ditësh, pas paraqitjes së kërkesës së përsëritur, pala mund të fillojë kontestin gjyqësor, sikur ankesa-kërkesa të ishte refuzuar”.

Meqenëse e paditura nuk ka marrë vendim as pas kërkesës së përsëritur të paditësit të dt.01.06.2017, Gjykata vlerëson se paditësi me të drejtë ka iniciuar, kontestin gjyqësor kundër të paditurës, për shkak të heshtjes së administratës, me qenë se marrja e vendimit sipas ankesës së paraqitur dhe dorëzimi i saj palës në procedurë, është obligim i organit të paditur.

Mbi këto arsye Gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative, ligji është zbatuar në dëm të paditësit, kështu që në riprocedurë organi i paditur, do të ketë parasysh theksimet nga ankesa e paditësit drejtuar të paditurës me dt.18.04.2017, të vërtetoi faktet relevante në ankesë, të vlerësoj çdo pretendim të paditësit në ankesë dhe pastaj të marrë një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura, janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Prandaj, bazuar në arsyet e dhëna më lart, dhe duke u bazuar në neni 5, 6, 29 dhe 38, si dhe nenit 46.2 dhe 3 të Ligjit për Konfliktet Administrative, Gjykata ka aprovuar padinë e paditësve dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
A.nr.1028/2017, dt.17.12.2020

Zyrtar Ligjor  
Fatlum Gashi

G j y q t a r  
Hajriz Hoti

Këshillë Juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatë e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2020:050746  
Datë: 17.12.2020  
Numri i dokumentit: 01351383